

Ekspeditë kërkimore-shkencore në Rrafshin e Dukagjinit

Instituti Albanologjik i Prishtinës dhe Institutit i Kulturës Popullore i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë organizuan ekspeditë të përbashkët kërkimore-shkencore në Rrafshin e Dukagjinit, prej 21 deri më 29 qershor 2000. Bartëse e organizimit të ekspeditës ishte Dega e Folklorit e IAP-it.

Në ekspeditë morën pjesë këta studiues nga Tirana: as. prof. Afërdita Onuzi (drejtoreshë), dr. Agim Bido, prof. dr. Mark Tirta, prof. dr. Ramazan Bogdani, prof. dr. Ali Muka, as. prof. Agron Xhagolli, as. prof. Yllka Selimi, as. prof. Kahreman Ulqini, Fatmir Boshnjaku (fotoreporter), kurse nga Prishtina: dr. Zymer Neziri, Ramadan Ibrahim, mr. Begzad Baliu, mr. Naser Pajaziti, as. Arbnora Dushi, mr. Lush Culaj. Morën pjesë edhe studiuesit dr. Abdullah Zymberi, as. Myrvete Dreshaj, mr. Hatixhe Hoxha.

Pika të hulumtimit qenë Korisha, Bresana e krahinës së Opojës, Gjonajt dhe Brekoci të krahinës së Hasit, Krusha e Vogël, Krusha e Madhe dhe Celina të krahinës së Drinisë, Brovina e Juniku të Rekës së Keqe dhe Çarshia e Gjakovës.

Qëllimi i kësaj ekspedite ishte mbledhja e materialit të nevojshëm për konferencën shkencore *Mbijetesa etnokulturore e Kosovës*, e planifikuar për vjeshtë 2000. U shënuar material etnografik me vlerë për veshje popullore, për rite e mite, për doke e zakone dhe për lëvizje të popullsisë, për ndërtimtarinë popullore, si dhe u filmuan një pjesë e Çarshisë së Gjakovës dhe disa kulla të dëmtuara nga lufta në Rekë të Keqe.

Me interes janë materialet për heroin e ri epik, për efektet e Lëvizjes së Pajtimit të Gjaqeve gjatë luftës 1997-1999, për fenomenin e shpërnguljes, për motivet denominuse në antroponiminë e të dëbuarve të Kosovës gjatë viteve 1998-1999, për leksikun e të dëbuarve, për motivet e riemërtimeve toponimike në Kosovë më 1999, për dallimet esenciale ndërmjet dy popujve fqinj etj.. Përveç valleve, u gjurmuan instrumentet popullore, sidomos lahuta, kurse për ciklin e kreshnikëve u gjetën gjurmë në Gjonaj. Në fushë të lirikës u gjurmuan këngët e përgimit, gjama dhe vajet.

Kjo ekspeditë ishte vazhdim i asaj të vitit të kaluar, e cila u bë ndër kosovarët e shpërngulur në Durrës dhe në rrethinën e tij. E veçanta e kësaj ekspedite është se për herë të parë, po organizohet një ekspeditë e përbashkët e Institutit të Kulturës Popullore dhe e Institutit Albanologjik të Prishtinës, pas një ndërprerjeje mbi 20 vjet, të cilën e shkaktuan rrethanat politike shumë të rënda, sidomos ato pas vitit 1981.

Zymer NEZIRI